

TERMAT E REFERENCËS

Shërbimi i sigurisë fizike dhe mirëmbajtjes së sistemit mbështetës të sigurisë për nënzonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit

1. HYRJA DHE HISTORIKU

Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit (Fondacioni), është bashkëthemeluar nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF) si një organizatë jofitimprurëse pa anëtarësim. Fondacioni operon në fushën e trashëgimisë kulturore dhe konkretisht qëllimi i saj është administrimi i nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit me vlerë universale, në përputhje me ligjin nr. 50/22 “Për miratimin e marrëveshjes për administrimin e nënzonave të trashëgimisë kulturore dhe peizazhi kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Fondacioni i Menaxhimit të Butrintit”.

Të gjitha masat e sigurisë në nënzonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit luajnë një rol kyç për ruajtjen fizike të pasurisë kulturore dhe për të krijuar një mjedis të sigurt dhe të qetë për të gjithë stafin, vizitorët dhe pjesëmarrësit.

2. OBJEKTI I SHËRBIMEVE

Në kuadër të administrimit të nën-zonave të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor të Parkut kombëtar të Butrintit, Fondacioni kërkon angazhimin e një subjekti të licencuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike me roje private.

Propozimet kërkohen nga kompani të licencuara dhe me reputacion që ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh sigurie me të paktën pesë vjet përvojë paraprake në mbikëqyrjen e objekteve të rëndësisë së veçantë dhe trajtimin e situatave të ndryshme emergjente, duke përfshirë monitorimin e sistemit CCTV, menaxhimin e zjarrit dhe kontrollin e pikave të evakuimit.

Objekti i shërbimeve të sigurisë fizike përfshin:

- 2.1 Shërbim sigurie me personel brenda dhe jashtë Qytetit Antik, brenda kufijve të perimetrit të nënzonave të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit;
- 2.2 Mirëmbajtje të sistemit mbështetës të sigurisë (CCTV);
- 2.3 Mbikëqyrje 24 orë të CCTV me operator;
- 2.4 Pajisja dhe mobilimi i Sallës së Monitorimit në Butrint;

Nënkontraktimi nuk inkurajohet, por nëse është i nevojshëm, lejohet vetëm për pajisjen dhe mobilimin e Sallës së Monitorimit dhe mirëmbajtjen e sistemit CCTV në Butrint.

3. SHËRBIMI I PRITSHËM PËR PËRMBUSHJEN E OBJEKTIT TË KONTRATËS

Në lidhje me shërbimin e sigurisë fizike me personel dhe mbikëqyrjes së kamerave sipas licencës në kategorinë 1.3.A, Ofruesi i Shërbimit pritet të performojë në një nivel ekselence duke ofruar shërbimet e mëposhtme:

- 3.1 Hartimi i skemës së sigurisë, për miratim nga Policia e Shtetit;
- 3.2 Shërbimi i sigurisë së nënzonave të trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit nëpërmjet personelit dhe mjeteve të teknologjisë;
- 3.3 Shërbim i mirëmbajtjes së sistemit mbështetës të sigurisë (CCTV) të Fondacionit për t'u siguruar që është funksional 24/24, 7/7. Fondacioni do të kryejë zëvendësimin e sistemit të

monitorimit CCTV ekzistues dhe shtrirjen e sistemit të monitorimit CCTV në park, ndërsa pritet që mirëmbajtja dhe zgjidhja e problematikave teknike që nuk mbulohen nga garancia e sistemit të kryhet nga Ofruesi i Shërbimit (15 -20 kamera 5 megapixel me IP, 2 NVR);

- 3.4 Furnizimi, transporti, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve teknologjike dhe të mobilimit të Sallës së Monitorimit në Butrint. Të gjitha kamerat dhe sensorët të lidhen me Sallën e Monitorimit në Butrint, e cila shërben për të koordinuar punën dhe emergjencat me forcat e zbatimit të ligjit dhe urgjencat publike dhe do të monitorohet gjatë të gjithë kohës (24/7). Kjo Sallë Monitorimi do të shërbejë si qendra kryesore e koordinimit midis rojeve të sigurisë, të ndërhyjë për parandalimin ose ndalimin e veprimtarive keqbërëse në dëm të pasurisë së Parkut, punonjësve apo vizitorëve, dhe do të ofrojë ekip të gatshëm 24/7 me një kohë përgjigje sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
- 3.5 Shërbimi i mbikëqyrjes së kamerave CCTV përmes vëzhgimit të pandërprerë 27/7 të imazheve të ofruara nga teknologjia në Sallën e Monitorimit në Butrint;
- 3.6 Raportimi mujor pranë Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit;
- 3.7 Respektimi i orarit të shërbimeve të sigurisë;
- 3.8 Përgjigje dhe reagim i menjëhershëm me ndërhyrje dhe raportim ndaj vëzhgimeve, ngjarjeve.
- 3.9 Reagim ndaj kërkesave përkatëse të Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit;
- 3.10 Respektimi i standardeve të cilësisë së shërbimit sipas kërkesave të kontratës dhe ligjit në fuqi.
- 3.11 Sugjerime për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e sigurisë, duke analizuar nevojat dhe sugjeruar zgjidhjet përkatëse.
- 3.12 Kontrollin e aksesit në të gjitha ambjentet e Qytetit Antik të Butrintit përfshi dhe perimetrin.
- 3.13 Patrullimin e vazhdueshëm në të gjitha ambjentit e objektit dhe perimetrin e tij.
- 3.14 Të përgjigjet pa vonesë gjatë emergjencave të tilla si, por pa u kufizuar në emergjencat e zjarrit, termeteve, sulmeve terroriste dhe çdo lloj aktiviteti kriminal që mund të cenojë fizikisht stafin, klientët, asetet dhe site-et.
- 3.15 Të zhvillojë në detaje procedurat e shërbimit për secilin vendroje të kombinura edhe me monitorimin e sistemeve të sigurisë dhe ndërveprimin mes rojeve dhe qendrës operative si dhe mënyrën e reagimit në situata emergjente.
- 3.16 Të kryejë trajnimet përkatëse për stafin e sigurisë dhe personelin e sitit për të gjitha procedurat e situatave emergjente sipas kërkesave të ligjit dhe nevojave specifike të parkut.
- 3.17 Ofruesi i Shërbimit do të sigurojë një komunikim të mirë dhe mjete alternative komunikimi krahas celularëve edhe mjete si radio (veçanërisht midis rojeve të sigurisë), telefon satelitor në rast të prishjes së komunikimeve të tjera gjatë emergjencave.
- 3.18 Rinovim të çertifikatave të rojeve në kohën e duhur në mënyrë që parku të mosurvejohet në asnjë moment nga staf i pacertifikuar.

4. PËRGJEGJËSITË E OFRUESIT TË SHËRBIMIT

4.1 Shërbimi me punonjës shërbimi

Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, kërkohet shërbim me punonjës shërbimi të sigurisë së jashtme dhe të brendshme, fikse dhe me patrullim për të paktën vendet dhe oraret e mëposhtme, si dhe verifikim i sinjalit të alarmit gjatë 24 orëve dhe reagimi me grup të gatshëm sa herë ka ngjarje që kërcënojnë sigurinë e individit apo të pasurisë.

Ofruesi i Shërbimit pritet të ofrojë roje të kualifikuar, me shëndet të mirë dhe në formë fizike optimale, të aftë për të mbrojtur të tjerët dhe veten e tyre, dhe të njohur me ligjin dhe kërkesat e kontratës në lidhje me shërbimin dhe përgjegjësitë.

Ofruesi i Shërbimit do të caktojë një personel sigurie që të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e rojeve, i disponueshëm sipas orarit të punës të mëposhtëm. Personeli kryesor i propozuar duhet të ketë certifikatën e duhur sipas kërkesave ligjore.

Gjatë periudhës Nëntor- Mars, Ofruesi i Shërbimit kërkohet të mbulojë me shërbim sigurie pikat kryesore të pasurisë kulturore, sipas kohëzgjatjes së mëposhtme me një staf total prej 24 punonjës shërbimi:

Nr.	Objekti	Lloji i Shërbimit	Kohëzgjatja
1.	Biletaria	Vendroje	24/24, 7/7
2.	Kalaja – Muzeu	Vendroje	24/24, 7/7
3.	Teatër	Vendroje	09:00-18:00, 7/7
4.	Baptister – Bazilika e Madhe	Patrullim	09:00-18:00, 7/7
5.	Kulla Veneciane – Pallati Trikonkë – Shtëpia e Tregtarit Venecian – Porta e Ujit	Patrullim	09:00-18:00, 7/7
6.	Porta e Ujit - Porta e Liqenit - Porta e Luanit	Patrullim	09:00-18:00, 7/7
7.	Porta e Luanit – Akropol	Patrullim	09:00-18:00, 7/7
8.	Kalaja trekëndore	Vendroje	09:00-17:00, 7/7
9.	Zona e Diaporitit	Patrullim	09:00-17:00, 7/7
10.	Fushë Vrinë	Patrullim	09:00-17:00, 7/7
11	Salla e Monitorimit	Monitorim i sistemit CCTV	24/24 7/7

Gjatë periudhës Prill – Tetor, Ofruesi i shërbimit kërkohet të mbulojë me shërbim sigurie pikat kryesore të pasurisë kulturore, sipas kohëzgjatjes së mëposhtme me një staf total prej 31 punonjës shërbimi:

Nr.	Objekti	Lloji i Shërbimit	Kohëzgjatja
1.	Biletaria	Vendroje	24/24, 7/7
2.	Kalaja	Vendroje	24/24, 7/7
3.	Ambjenti brenda Muzeut	Vendroje	9:00-20:00, 7/7
4.	Teatër	Vendroje	09:00-20:00, 7/7
5.	Baptister – Bazilika e Madhe	Patrullim	09:00-20:00, 7/7
6.	Baptister	Vendroje	09:00-20:00, 7/7
7.	Kulla Veneciane – Pallati Trikonkë –	Patrullim	09:00-20:00, 7/7

	Shtëpia e Tregtarit Venecian – Porta e Ujit		
8.	Porta e Ujit - Porta e Liqenit - Porta e Luanit	Patrullim	09:00-20:00, 7/7
9.	Porta e Luanit – Akropol	Patrullim	09:00-20:00, 7/7
10.	Kalaja trekëndore	Vendroje	09:00-17:00, 7/7
11.	Zona e Diaporitit	Patrullim	09:00-17:00, 7/7
12.	Fushë Vrinë	Patrullim	09:00-17:00, 7/7
13	Salla Operative	Monitorim i sistemit CCTV	24/24 7/7

Disa nga përgjegjësitë e Ofruesit të Shërbimit në lidhje me shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike janë si më poshtë:

1. Fillimi i shërbimit dhe trajnimi i stafit

- Në datën e nisjes së kontratës, Ofruesi duhet të zbatojë një program sigurie që përfshin një plan trajnimi për të gjithë punonjësit e angazhuar.
- Trajnimi fillestar do të përfshijë njohjen me objektin dhe procedurat e sigurisë dhe do të përsëritet të paktën çdo gjashtë muaj.
- Duhet të kryhen gjithashtu trajnime specifike për masat e sigurisë të Parkut.

2. Organizimi dhe zbatimi i shërbimit të sigurisë

- Ruajta dhe siguria në çdo post shërbimi, si dhe ruajtja, mbikëqyrja dhe kontrolli i të gjithë territorit që shikohet nga vendroja, si dhe patrullim të rregullt në territor për të parandaluar dëmtimin ose shkatërrimin e pronës së Parkut.
- Kontroll i aksesit për personat, pajisjet dhe automjetet, duke lejuar hyrjen/daljen vetëm nga pikat e autorizuar dhe me miratimin e Fondacionit.
- Ndalimi i hyrjes në zona me akses të kufizuar dhe parandalimi i ngjitjes në monumente ose veprimeve të tjera që rrezikojnë pasurinë kulturore.

3. Pajisjet, personeli dhe kushtet e punës

- Sigurimi i të gjithë personelit të nevojshëm, mbikëqyrjes dhe pajisjeve për kryerjen e shërbimit.
- Pajisja e stafit me uniforma dhe veshje sezonale në përputhje me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Sigurimi i mjeteve të komunikimit (radio, celular, telefon satelitor për emergjencë) për koordinim të brendshëm dhe me Sallën e Monitorimit.
- Mbulimi i të gjitha shpenzimeve ligjore dhe financiare për personelin, përfshirë pagat, sigurimet shoqërore dhe sigurimin në punë.
- Punonjësit e Ofruesit nuk konsiderohen në asnjë moment punonjës të Fondacionit.

4. Reagimi ndaj incidenteve dhe emergjencave

- Reagim i menjëhershëm me grup të gatshëm ose forca shtesë për normalizimin e situatave të dhunshme, konflikteve rastësore dhe ngjarjeve kritike.
- Koordinim dhe bashkëpunim me Policinë e Shtetit, shërbimet zjarrfikëse, emergjencat mjekësore dhe autoritete të tjera ligjzbatuese.
- Operatorët e Sallës së Monitorimit në Butrint, pasi vihen në dijeni nëpërmjet sistemit CCTV apo pas njoftimit nga roja, informojnë menjëherë autoritetet përkatëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe Fondacionin për çdo incident.

5. Përgjegjësia ligjore dhe financiare

Ofruesi mban përgjegjësi të plotë për çdo dëm ose vjedhje që ndodh si rezultat i mungesës së vigjilencës ose organizimit të dobët të shërbimit dhe detyrohet të zhdëmtojë pasurinë e dëmtuar/vjedhur në masën 100% të vlerës.

6. Kontrolli i ambienteve

- Në përfundim të orarit zyrtar, kryhet kontroll për mbylljen e dyerve dhe dritareve, fikjen e ndriçimit dhe verifikimin e sigorisë së objektit.
- Çdo problem i konstatuar raportohet menjëherë tek pika e kontaktit e Fondacionit për marrjen e masave.

Shërbimi i rojeve për çdo objekt duhet të sigurojë, rendin dhe qetësinë për personelin, konform ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigorisë fizike” të ndryshuar, legjislacionit shqiptar në fuqi dhe standardeve dhe praktikave më të mira. Ofruesi i shërbimit duhet të sigurojë pajisjet, mjetet dhe uniformat e punës sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

4.2 Ngritja e Sallës së Monitorimit në Parkun Kombëtar të Butrintit

Vendi do të përcaktohet nga Fondacioni dhe Ofertuesi merr përsipër pajisjen me infrastrukturën e nevojshme si më poshtë:

Produkti	Sasia	Detaje teknike kryesore
TV 55 inç 4K LED	4	4K, 55" LED, për punë 24/7
Rack 22U 600×600 mm	1	Kabinet metalik 22U, 600×600 mm
Kompjuter menaxhimi	1	Core i5, 16 GB RAM, SSD 512 GB, monitor 24" FHD
Monitor 24" FHD	1	Rezolucion 1920×1080, LED
UPS 3 kVA online	1	UPS 3000 VA (double conversion), dalje 230 V
Bravë elektronike për derën	1	PIN + kartë RFID, akses kontrolli
Patch panel 24 porta Cat6	1	Panel me 24 porta RJ-45 Cat6/Cat6A
HDD survejimi 8 TB	2	Disqe 3.5", 7200 rpm, të dedikuar për survejim
Instalimi dhe konfigurimi	1	Punë fizike dhe konfigurim softuerësh
Switch PoE 24 porta	1	PoE+ me buxhet ≥ 250 W, montim rack
Mobilimi	1	2 Karrige + 1 Tavolinë

Qendra e monitorimit do të ketë survejim me operator 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. Me lidhjen e kontratës Ofertuesi duhet të ofrojë garanci jo më pak se 2 vjet për pajisjet e mësipërme.

4.3 Mirëmbajtja e sistemit mbështetës të sigorisë CCTV

Ofruesi i Shërbimit duhet të garantojë mirëmbajtjen dhe funksionimin pa ndërprerje të pajisjeve të rrjetit dhe sistemeve të mbikëqyrjes me kamera. Qëllimi është të sigurohet performancë maksimale dhe ruajtje e sigurtë e të dhënave sipas detyrimeve ligjore.

4.3.1. Mirëmbajtja e Switcheve

- Ofruesi i Shërbimit duhet të ofrojë mirëmbajtje të plotë për switchet e instaluar, duke adresuar në kohë çdo problem që lidhet me output-in PoE.
- Duhet të kryhet diagnostikim i rregullt për të siguruar që switchet funksionojnë brenda parametrave të lejuar teknikë.
- Ofruesi i Shërbimit duhet të zgjidhë çdo problem që ndikon në furnizimin me energji përmes PoE, duke siguruar që ndërprerja e shërbimit të mos zgjasë më shumë se 2 orë në total. Zgjidhja e përkohshme duhet të realizohet brenda maksimumi 2 orëve nga raportimi, për të rikthyer funksionimin e sistemit, ndërsa zgjidhja përfundimtare duhet të jepet brenda maksimumi 6 orëve nga raportimi.

4.3.2. Mirëmbajtja e Kamerave

- Ofruesi i Shërbimit duhet të mirëmbajë dhe optimizojë cilësimet e kamerave për efikasitet maksimal, duke siguruar që regjistrimi të bëhet me bazë lëvizje (motion recording).
- Rekomandohet të konfigurohet RAID për të siguruar që, në rast dështimi të njërës pajisje, regjistrimi të vazhdojë automatikisht në pajisjen tjetër. Ky konfigurim kërkon kapacitet shtesë storage për të ruajtur kopjen rezervë të të dhënave.

4.3.3. Sigurimi i Licencave

- Ofruesi i Shërbimit është i detyruar të sigurojë të gjitha licencat e nevojshme të software-it në përputhje me kontratën, për të gjithë periudhën e mirëmbajtjes.
- Duhet të sigurohen licencat për workstation-et në rast se përdoret sistemi operativ Windows.
- Duhet të sigurohen licencat e nevojshme për switchet, në varësi të specifikimeve dhe kërkesave të vendorit/prodhuesit.

4.3.4. Afatet e Reagimit dhe Zëvendësimit

- Çdo dëm fizik i pajisjeve duhet të riparohet ose pajisja të zëvendësohet brenda maksimumi 48 orëve nga momenti i raportimit.
- Ofruesi i Shërbimit duhet të ketë një sistem të qartë komunikimi për raportimin e defekteve dhe ndjekjen e statusit të riparimit.

Për defekte/problematika të tjera të funksionimit të sistemit CCTV përveç atyre të përcaktuara më sipër, kompania fituese do të duhet të përgjigjet sipas prioritetit të problematikës sipas afateve të mëposhtme:

Kategoria A (Kritik/ I Larte)	Kategoria A (I Mesem)	Kategoria C (I Ulet)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimal aktivitetin
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>shumë të madh</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <i>të vogël</i> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë pjesë të punës së tyre</u>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit <u>të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre</u>
Zgjidhje alternative e përkohshme		
<u>Nuk ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<u>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<u>Ka një mënyrë alternative</u> të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
• 10 min. për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 1 ore.	• 30 min.për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 8 orëve	• 60 min.për të kthyer përgjigje • Në vend brenda 10 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimi të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

5. KOHËZGJATJA

Ky shërbim do të fillojë me lidhjen e kontratës për një kohëzgjatje prej 2 vjetësh, me mundësi rinovimi.

6. SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË PUBLIKE

Në zbatimin e kësaj kontrate, përgjegjësia e përgjithshme bie mbi Ofruesin e Shërbimit. Ofruesi i Shërbimit do të jetë përgjegjës për çdo dëmtim të pasurisë ose lëndim trupor, duke përfshirë vdekjen, në pronësi ose të pësuar nga Fondacioni ose ndonjë palë e tretë.

Ofruesi i Shërbimit do të marrë sigurimin e përgjegjësive publike me një kompani sigurimesh me reputacion. Kufiri minimal i dëmshpërblimit do të jetë 1,000,000 € për ndodhi ose në total.

7. NDËRVEPRIMI ME FONDACIONIN

Performanca e Ofruesit të Shërbimit do të mbikëqyret nga Menaxheri i Sektorit të Infrastrukturës pranë Fondacionit. Megjithatë, Ofruesi i Shërbimit do të ndërveprojë me palë të ndryshme brenda Fondacionit, siç mund të kërkohej për ofrimin e shërbimeve, duke përfshirë ekipin e sigurisë dhe shëndetit.

Ofruesi i Shërbimit do të raportojë pranë pikës së kontaktit të vendosur nga Fondacioni në lidhje me kryerjen e shërbimit, incidentet e ndodhura çdo ditë, përshkrimin dhe kohën e zgjidhjes së tyre. Ofruesi i Shërbimit do të bashkëpunojë me Fondacionin ose palë të treta të caktuara nga ky i fundit për monitorimin dhe vlerësimin, duke ofruar të gjithë informacionin dhe burimet në dispozicion brenda një kohe të arsyeshme.

8. PËRPUTHSHMËRIA ME POLITIKAT DHE PROCEDURAT E BRENDSHME TË FONDACIONIT

Ofruesi i Shërbimit do të angazhohet të veprojë në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme të Fondacionit, veçanërisht por pa u kufizuar në ato për:

- sigurinë dhe shëndetin në punë, sigurinë fizike dhe menaxhimin e risqeve ndaj fatkeqësive natyrore,
- mbrojtjen e të dhënave personale
- kontrollin e dokumentacionit.

Ofruesi i Shërbimit do të rishikojë ofrimin e shërbimeve në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme të Fondacionit në bazë vjetore.

Ofruesi i Shërbimit do të zhvillojë në bashkëpunim me Fondacionin rregulloren e brendshme për ruajtjen dhe sigurinë fizike në nënzonat e pasurisë dhe peizazhit kulturor pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit, duke specifikuar detyrat e secilit punonjës shërbimit të angazhuar në ofrimin e shërbimeve sipas kontratës së shërbimit që do të lidhet mes palëve.

ANEKSI 1 – Skemat e Evakuimit



ANEKSI 2 – Evidentimi i zonave me potencial hyrjeje të jashtëligjshme.

